



www.qbz.gov.al

# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2015 – Numri: 203

---

Tiranë – E mërkurë, 25 nëntor 2015

---

## PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 930, datë 18.11.2015	Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Luftën kundër Ekstremizmit të Dhunshëm dhe planit të veprimit..... 13247



**VENDIM**  
**Nr. 930, datë 18.11.2015**

**PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË  
KOMBËTARE PËR LUFTËN KUNDËR  
EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM DHE  
PLANIT TË VEPRIMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, ministrit të Arsimit dhe Sportit, ministrit të Punëve të Brendshme, ministrit të Mbrojtjes dhe ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e Strategjisë Kombëtare për Luftën kundër Ekstremizmit të Dhunshëm dhe planit të veprimit, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen ministri i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, ministri i Arsimit dhe Sportit, ministri i Punëve të Brendshme, ministri i Mbrojtjes dhe ministri i Punëve të Jashtme për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI**  
**Edi Rama**

**STRATEGJIA KOMBËTARE  
PËR LUFTËN KUNDËR EKSTREMIZMIT  
TË DHUNSHËM DHE PLANI I VEPRIMIT**

**Nxitja e një mjedisi të sigurt, bazuar në respektimin e të drejtave dhe vlerave themelore**

Kombi shqiptar është themeluar mbi vlerat demokratike dhe një traditë bashkëjetese fetare. Vizioni ynë i përbashkët është të kultivojmë një shoqëri që mbështetet mbi respektin që ndajmë bashkërisht për të drejtat e njeriut, shtetin e së drejtës, barazinë dhe liritë themelore.

Paqja, stabiliteti dhe begatia në mbarë rajonin janë, po ashtu, me rëndësi strategjike për Shqipërinë. Është në interesin e Shqipërisë që të nxitë marrëdhënie të mira me fqinjët, mbi bazën e besimit të ndërsjellë dhe përfshirjes, të cilat mbizotërohen nga harmonia ndëretnike dhe ndërjetare.

Mbrojtja dhe përhapja e këtyre vlerave ka rëndësi gjithnjë e më të madhe në botën tonë që

është përherë në ndryshim, ku kërcënimi i ekstremizmit të dhunshëm nuk njihet kufij.

**Angazhimi i Shqipërisë për të luftuar kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit**

Ekstremizmi i dhunshëm e radikalizmi, në të gjitha format e shfaqjet, përbëjnë, aktualisht, kërcënime të serioze për paqen dhe sigurinë në mbarë botën. Kësaj, lufta kundër këtyre kërcënimeve, pavarësisht se ku ndodhin apo nga kush vijnë, kërkon që aktorët qeveritarë të forcojnë bashkëpunimin në nivel kombëtar, si dhe atë rajonal e global.

Në konceptimin e një kundërpërgjigjeje shqiptare ndaj ekstremizmit të dhunshëm, Strategjia Globale e Kombeve të Bashkuara kundër Terrorizmit do të mbetet platforma e përbashkët për të gjitha përpjekjet e ardhshme. Për më tepër, Shqipëria do të vijojë të mbështetë fort përpjekjet ndërkombëtare kundër terrorizmit, si dhe të përhapë standardet e Kombeve të Bashkuara kundër terrorizmit, ndërkohë që garanton të drejtat e njeriut dhe forcon shtetin e së drejtës.

Shqipëria është e angazhuar që të japë një kontribut thelbësor e të prekshëm në përpjekjet ndërkombëtare kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit:

- Shqipëria ishte mes vendeve të para që iu përgjigjën sfidës që lidhej me ekstremizmin e dhunshëm dhe, aktualisht, po luan një rol aktiv si pjesë e koalicionit global në luftën kundër ISIL /Da'esh-it.

- Shqipëria ka nënshkruar e ratifikuar konventat dhe protokollet e Kombeve të Bashkuara mbi terrorizmin dhe, përpos kësaj, është bashkësponsorizuese e Rezolutës 2178 (2014) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, si edhe Konventës së Këshillit të Evropës për Parandalimin e Terrorizmit.

- Në maj të vitit 2015, Shqipëria mbajti Samitin Rajonal Ballkanik kundër Ekstremizmit të Dhunshëm në Tiranë, ku përfaqësues të vendeve të rajonit theksuan nevojën për përmirësimin e bashkëpunimit, jo vetëm për t'iu kundërpërgjigjur ekstremizmit, por edhe për t'u përballur me vështirësitë lidhur me të që has rajoni.

Bashkë me samitin e majit të vitit 2015, në Tiranë, Samiti i Shtëpisë së Bardhë kundër Ekstremizmit të Dhunshëm (shkurt 2015) dhe Samiti i Udhëheqësve në Nju-Jork (shtator 2015)



janë gurë të rëndësishëm kilometrikë në zbatimin e Strategjisë Globale të Kombeve të Bashkuara kundër Terrorizmit.

### **Masat e brendshme të luftës kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit**

Brezi ynë ka përgjegjësinë historike që të krijojë një mjedis që ofron siguri e mirëqenie për brezat e ardhshëm. Për këtë qëllim, ne, qoftë si individë apo si shoqëri, duhet të angazhohemi për t'u përballur me kërcënimet ndaj sigurisë që sjell koha, duke dëshmuar vullnet dhe vendosmëri civile.

Në qershor të vitit 2014, qeveria shqiptare rishikoi dhe miratoi Strategjinë e saj Kombëtare të Sigurisë, e cila parashton detyrimet e saj kushtetuese për garantimin e sigurisë kombëtare, si dhe forcimin e lirive themelore, të drejtave të njeriut dhe shtetit të së drejtës, mbrojtjen e interesave të qytetarëve shqiptarë, kudo ata ndodhen, si dhe nxitjen e identitetit kombëtar.

Një komponent i rëndësishëm i Strategjisë Kombëtare për Sigurinë trajton shqetësimet që lidhen me ekstremizmin e dhunshëm dhe radikalizmin. Si kundërpërgjigje ndaj këtyre shqetësimeve, strategjia përfshin një sërë veprimesh, që synojnë:

- Zgjerimin dhe përmirësimin e kuadrit ligjor shqiptar për përcaktimin si vepër penale të të gjitha formave të ekstremizmit të dhunshëm, si dhe të rekrutimit të luftëtarëve të huaj terroristë;

- Forcimin e kapaciteteve dhe ekspertizës së zyrtarëve të zbatimit të ligjit, për të parandaluar ekstremizmin e dhunshëm;

- Nxitjen e institucioneve shtetërore për t'u angazhuar me bashkësitë vendore, përfaqësuesit fetarë dhe aktorë të tjerë, me qëllim identifikimin e grupeve në nevojë, që janë a mund të bëhen shënjestër e ekstremizmit të dhunshëm;

- Identifikimin dhe kuptimin e shqetësimeve sociale të komuniteteve lokale, në mënyrë që të bëhet i mundur trajtimi i shkaqeve rrënjësore të radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm;

- Hartimi i programeve dhe politikave specifike të përshtatura, për të parandaluar përhapjen e dhunës dhe ekstremizmit dhe, njëkohësisht, për të rritur ndërjegjësimin e shoqërisë mbi këto dukuri.

Më tej, analiza vjetore e zbatimit të Strategjisë Kombëtare të Sigurisë përcakton detyra specifike që institucionet shtetërore dhe aktorë të tjerë kombëtarë duhet të marrin përsipër, për rritjen e gjithanshme të efektivitetit në luftën kundër

radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm.

### **Qëllimi i strategjisë**

Duke qenë se ekstremizmi i dhunshëm është një dukuri bashkëkohore globale dhe, aktualisht, përbën një kërcënim serioz ndaj paqes e sigurisë ndërkombëtare, qeveria shqiptare e konsideron luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm një prej përparësive themelore të programit të saj politik.

Për të parandaluar me sukses përhapjen e ekstremizmit të dhunshëm, duhen përpjekje të lokalizuara, përfshi fuqizimin e mëtejshëm të të rinjve, familjes, grave dhe pakicave. Duke i kanalizuar këto përpjekje drejt rrjeteve fetare, kulturore dhe arsimore, Strategjia do të sigurojë përfshirjen e shoqërisë civile, si e tërë, në miratimin e një qasjeje të përshtatur dhe proaktive për trajtimin e kësaj dukurie.

Kjo strategji do t'i japë qeverisë shqiptare mundësinë të hartojë parime drejtuese, politika dhe veprime për t'u përballur me radikalizmin dhe ekstremizmin e dhunshëm. Duke pasur si qëllim të vetin përfundimtar krijimin e një mjedisi të begatë e gjithëpërfshirës për qytetarët, strategjia në fjalë do të kultivojë, po ashtu, kulturën e respektimit të lirive themelore në mbarë vendin.

Është e ditur se, në një periudhë afatgjatë, më efektive në luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm janë ato politika dhe masat që ndiqen përmes nismave të nxitura lokalisht dhe atyre të bashkë-punimit, që iu përshtaten konteksteve lokale. Në këtë mënyrë, një qasje me në qendër komunitetin do të jetë themelore për ta përqendruar e nxitur luftën e Shqipërisë kundër ekstremizmit të dhunshëm. Kjo qasje do të mbështetet përmes një bashkërendimi në rritje të institucioneve qeveritare dhe aktorëve të komunitetit lokal.

Një tjetër tipar i rëndësishëm i kësaj qasjeje është të krijohet një ide më e mirë për policimin në komunitet. Aftësia e policisë për të ndërvepruar efektivisht me komunitetet lokale është kyçe në nxitjen e përpjekjeve të mbështetura në partneritet për identifikimin, parandalimin dhe zgjidhjen e krimeve në mënyrë më efektive, duke i trajtuar problemet e sigurimit fizik dhe sigurisë njëkohësisht me përmirësimin e kohezionit social.

Me pak fjalë, që radikalizmi dhe ekstremizmi i dhunshëm të luftohen me sukses, duhet bashkërendim i gjerë i përpjekjeve të ndryshme të brendshme dhe ndërkombëtare. Në kuadrin e kësaj



strategjie, ndarja e praktikave e përvojave më të mira për t'iu kundërpërgjigjur ekstremizmit të dhunshëm në të gjitha format e tij do t'u japë mundësi zyrtarëve shqiptarë të rritin kapacitetet dhe ekspertizën në luftën kundër radikalizimit, duke çuar më përpara sigurinë kombëtare dhe paqen.

### **Përkufizime**

“Radikalizimi në dhunë”, një vendim për të anashkaluar proceset politike apo metodat jo të dhunshme të nxitjes së ndryshimit, duke favorizuar përdorimin e metodave të dhunshme për të sjellë ndryshimin.

“Ekstremizëm i dhunshëm”, përdorimi i dhunës për arritjen e objektivave politike.

“Kundëradikalizimi”, një paketë programesh sociale, politike, ligjore, arsimore dhe ekonomike të hartuara posaçërisht për t'i frenuar individët e pakënaqur (dhe, me gjasë, tashmë të radikalizuar) që t'i drejtohen terrorizmit.

“Qëndresë”, faktorët, idetë, institucionet, çështjet, prirjet ose vlerat që iu japin mundësi individëve dhe komuniteteve t'i bëjnë qëndresë dhunës ose ta parandalojnë atë.

“Luftëtarë të huaj terroristë”, individë të cilët udhëtojnë drejt një shteti që nuk është shteti i tyre i qëndrimit apo nënshtetësisë, me qëllim kryerjen, planifikimin, përgatitjen apo pjesëmarrjen në akte terroriste ose ofrimin a përfundimin e trajnimit terrorist, qoftë ai edhe në lidhje me një konflikt të armatosur.

### **Misioni**

Strategjia Kombëtare për Luftën kundër Ekstremizmit të Dhunshëm synon të ruajë vlerat e tolerancës dhe harmonisë fetare, të mbrojtë të drejtat e njeriut, shtetin e së drejtës dhe demokracinë, si dhe të mbrojtë shoqërinë shqiptare nga ekstremizmi i dhunshëm.

Dokumenti ka katër objektiva strategjike që përbashkohen në kuadrin e objektivit të saj kryesor për zhvillimin e kapaciteteve të aktorëve të ndryshëm të përfshirë në veprimet kundër ekstremizmit të dhunshëm në Shqipëri, për të trajtuar me efektivitet kushtet që çojnë drejt radikalizimit. Me anë të angazhimit të aktorëve të shumëfishtë brenda dhe jashtë qeverisë, kjo strategji jo vetëm do t'i kundërvihet mesazheve terroriste dhe do të parandalojë përhapjen e ekstremizmit të dhunshëm brenda vendit, por edhe përtej kufijve të Shqipërisë. Për këtë qëllim,

strategjia në fjalë propozon një nismë për ngritjen e një kapaciteti e bashkëpunimi rajonal kundër ekstremizmit të dhunshëm (KEDH).

Në përputhje me misionin e saj, masat e propozuara në kuadër të kësaj strategjie:

- Do të forcojnë bashkërendimin, bashkëpunimin dhe partneritetin në nivel lokal, kombëtar e ndërkombëtar, mes agjencive qeveritare, organizatave joqeveritare, sektorit privat, bashkësive fetare dhe medias, në përcaktimin e zbatimit e ndërhyrjeve efektive të KEDH-së;

- Do të nxitin hulumtimin lokal për të kuptuar më mirë kushtet, faktorët dhe stimujt që nxitin radikalizimin drejt dhunës, si dhe nivelet aktuale të qëndresës së komunitetit ndaj ekstremizmit të dhunshëm;

- Do të përforcojnë qëndresën e komunitetit dhe do të tkurrin shkaqet që sjellin radikalizimin dhe ekstremizmin e dhunshëm përmes programeve e politikave parandaluese arsimore, të punësimit e policore, mbështetur në komunitet;

- Do të ulin ndikimin e propagandës së ekstremizmit të dhunshëm dhe rekrutimit në internet, duke shfrytëzuar medien sociale për hartimin dhe përcimin e mesazheve alternative pozitive.

### **Fushat kryesore dhe masat**

Angazhimi i komuniteteve, kundërvënia ndaj mesazhit ekstremist dhe hartimi i politikave gjithëpërfshirëse afatgjata kundër ekstremizmit të dhunshëm

Strategjia Kombëtare Shqiptare propozon 10 masa, të organizuara sipas tri fushave të përparësisë, për zhvillimin e kapaciteteve, politikave dhe mekanizmave për t'u përballur me ekstremizmin e dhunshëm dhe radikalizimin. Këto fusha kryesore janë:

- Shtrirja në komunitet dhe angazhimi i tij;

- Kundërvënia ndaj propagandës ekstremiste, duke përkrahur vlerat demokratike;

- Hartimi i politikave gjithëpërfshirëse afatgjata të KEDH-së.

Shtrirja në komunitet dhe angazhimi i tij

Komunitetet janë pikat qendrore për formulimin dhe zbatimin e politikave të KEDH-së në Shqipëri. Duke u mbështetur tek udhëzimet dhe praktikat më të mira të Forumit Global kundër Terrorizmit, Rrjetit të BE-së për Ndërgjegjësimin mbi Radikalizimin dhe të Organizatës për Siguri e Bashkëpunim në Evropë, masat e propozuara në



kuadër të kësaj fushe kryesore do të përmbajnë një qasje komunitare për të forcuar qëndresën ndaj qëllimeve ekstremiste të dhunshme. Sipas kësaj qasjeje nga poshtë lart, grupet komunitare do të fuqizohen për të luajtur një rol aktiv në parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm, në partneritet të ngushtë me agjencitë qeveritare, organizatat e shoqërisë civile, komunitetin e biznesit dhe median.

Masat dhe veprimet e propozuara në strategjinë kombëtare do të zbatohen përmes nismave të nxitura në nivel vendor, bashkëpunimit dhe mbështetjes në partneritet, që përputhen me kontekstin e këtyre masave, në funksion të rritjes së efektivitetit dhe qëndrueshmërisë së tyre. Angazhimi i komuniteteve do të jetë, gjithashtu, thelbësor për forcimin e besimit të publikut dhe mbështetjes për politikën e KEDH-së. Edhe pse veprimet e propozuara do të kenë kryesisht në shënjestër të rinjtë në zonat më problematike, suksesi i tyre do të varet nga përfshirja e të gjitha segmenteve të shoqërisë. Për rrjedhojë, do të ndërmerren veprime të posaçme që përqendrohen në shfrytëzimin maksimal të kompetencave të punonjësve që janë në vijën e parë: mësuesit, personeli policor, punonjësit socialë, udhëheqësit fetarë dhe individë të tjerë, të cilët kanë një pozicionim strategjik për parandalimin e radikalizimit.

Gjatë viteve të fundit, Shqipëria ka hartuar një sërë modelesh për ofrimin e shërbimeve sociale në komunitet, të cilat janë që të gjitha të përshtatura për t'iu përgjigjur kërkesave të grupeve në nevojë të identifikuar në këtë strategji. Më tej, ka një gamë strategjish dhe planveprimesh sektoriale që parashikojnë tanimë shpërndarjen e burimeve për zgjerimin e mëtejshëm të këtyre shërbimeve. Në kuadrin e kësaj fushe kryesore, metodat komunitare të ofrimit të shërbimeve publike do të kanalizohen për t'iu drejtuar komuniteteve më të rrezikuara.

1. Nxitja e mendimit kritik, pjesëmarrjes civile dhe inkurajimi i vlerave të tolerancës përmes arsimit

Nisma “Shkolla si qendër komunitare, një shkollë miqësore për të gjithë”, që është futur tashmë në sistemin arsimor shqiptar, do të zgjerohet për të mbështetur përpjekjet e KEDH-së, në kuadrin e strategjisë. Kjo nismë inkurajon partneritetet midis shkollave, familjeve dhe të gjithë komunitetit. Në këtë kuptim, shkollat nuk janë

thjesht ofrues të arsimit, por edhe katalizatorë të kohezionit e zhvillimit të komunitetit. Projekti “Shkolla si qendër komunitare” mund të shndërrohet në një instrument politik afatgjatë të fuqishëm, që i kundërpërgjigjet kërcënimit të ekstremizmit të dhunshëm, duke ofruar shërbime këshillimi e duke vepruar si hallkë qendrore në konceptimin e programeve parandaluese. Mësuesit janë punonjës të rëndësishëm të vijës së parë, të cilët shërbejnë si ndërlihdës brenda komuniteteve. Për rrjedhojë, aftësia e tyre për të shquar dhe për t'iu kundërpërgjigjur radikalizimit e, përfundimisht, për ta parandaluar atë, duhet forcuar.

Sipas Strategjisë së Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar (2014–2020), Ministria e Arsimit dhe Sportit ka në plan që, gjatë viteve pasardhëse të zgjerojë rrjetin “Shkolla si qendër komunitare”. Kjo masë do të përmbajë veprimet në vijim:

a) Zgjerimin e rrjetit “Shkolla si qendër komunitare” për t'u shtrirë në zonat problematike.

b) Fuqizimin dhe trajnimin e mësuesve për të dalluar e për të reaguar ndaj shenjave të radikalizimit.

c) Rritjen e mbështetjes për përpjekjet shkollore e jashtëshkollore në shkollat e synuara, për të parandaluar radikalizmin, përfshi edukimin civil e fetar, nismat artistike dhe sportive, klubet e debatit dhe veprimtari të ngjashme që rritin qëndresën.

2. Trajtimi i shkaqeve social-ekonomike që nxitin radikalizimin përmes arsimit dhe formimit profesional (AFP) dhe shërbimeve të punësimit

Të rinjtë e papunë në zonat me mundësi të kufizuara punësimi janë shënjestra të lehta të propagandës dhe rekrutimit ekstremist. Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi (2014–2020) e Shqipërisë identifikon përfshirjen sociale si një prej objektivave të saj dhe Shërbimi Kombëtar i Punësimit ka për qëllim të nxitë politika e programe aktive të përmirësuar e të diversifikuara të tregut të punës, që do t'iu vihen në dispozicion grupeve në nevojë. Për më tepër, planet ekzistuese për zgjerimin e shërbimeve të punësimit dhe formimit profesional në zonat rurale do të kenë si përparësi zonat problematike të synuara, duke ndërmarrë veprimet në vijim:

a) Zgjerimin e shërbimeve kombëtare të punësimit dhe mbështetjen aktive të tregut të punës për të mbërritur te grupet dhe individët më në rrezik;



b) Ofrimin e formimit profesional në zonat problematike të synuara (përfshirë njësitë e lëvizshme apo satelite), përshtatur për nevojat e popullsisë lokale;

c) Krijimin e nismave të ndihmës për punësim në institucionet e riedukimit, për të lehtësuar rehabilitimin dhe riintegrimin e autorëve të veprave të ekstremizmit të dhunshëm;

ç) Mbështetjen e nismave publike dhe private që krijojnë mundësi punësimi dhe fuqizimin ekonomik të grave në zonat problematike të synuara.

3. Krijimi i besimit dhe besueshmërisë dhe rritja e sigurisë së komunitetit përmes policimit në komunitet

Si pjesë të strategjisë së saj shtatëvjeçare (2007–2013), Policia e Shtetit në Shqipëri përfshiu modelin e “policimit në komunitet” për t’u zbatuar në të gjithë vendin. Zgjidhja proaktive e bashkëpunuese e problemeve, e përqendruar në parandalim, është me dobi veçanërisht kur trajtohen kërcënimet që kanë lidhje me ekstremizmin e dhunshëm. Për rrjedhojë, zgjerimi dhe rritja e aftësive të policimit në komunitet, duke e vendosur theksin te parandalimi i radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm, do të vendoset si përparësi përmes veprimit vijues:

a) Shfrytëzimi maksimal i kapaciteteve të policimit në komunitet në zonat problematike të synuara.

4. Fuqizimi i shoqërisë civile për të forcuar qëndresën e komunitetit

Angazhimi i organizatave të shoqërisë civile dhe grupeve vullnetare, në përpjekje për të parandaluar ekstremizmin e dhunshëm dhe për të luftuar radikalizimin është kyç për një strategji të suksesshme të KEDH-së. Projekte të mundshme të përbashkëta mund t’i përfshijnë ato në zonat problematike të synuara, që nxitin pjesëmarrjen civile, zhvillimin social-ekonomik, ndërgjegjësimin publik dhe ligjërimin mbi ekstremizmin e dhunshëm. Qeveria e Shqipërisë do të shqyrtojë alternativat e financimit së bashku me Agjencinë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, ministritë përkatëse dhe donatorët ndërkombëtarë, për të ngritur mekanizmin më të përshtatshëm për përkrahjen e projekteve të shoqërisë civile në zonat problematike të synuara, në përputhje me veprimtarinë vijuese:

a) Shpallja e thirrjeve për propozime për projekte që synojnë parandalimin e radikalizmit dhe rritjen e qëndresës së komunitetit ndaj ekstremizmit të dhunshëm.

**Lufta kundër propagandës ekstremiste, ndërkohë që përhapen vlerat demokratike**

Qeveria e Shqipërisë ka për qëllim që t’i kundërvihet mesazhit të ekstremizmit të dhunshëm, sidomos përçimit të tij përmes materialeve dhe mesazheve të fushatave në internet. Sa i përket kësaj fushe kryesore, Strategjia Kombëtare paraqet një qasje dykahëshe për diskreditimin dhe, më tej, dobësimin e ndikimit të propagandës ekstremiste.

Së pari, qeveria do të përmirësojë komunikimin me publikun për të rritur ndërgjegjësimin mbi radikalizimin dhe kërcënimet që e shoqërojnë. Përmes kanaleve të qarta dhe efektive të komunikimit, qoftë në internet ose jashtë tij, duke shfrytëzuar zëra të besueshëm, si udhëheqës komunitarë, autoritete fetare dhe të tjerë që shërbejnë si model, qeveria kërkon të ndërmjetësojë ligjërimin publik, të fuqizojë komunitetet lokale me informacion, të rrezojë mitet dhe t’u japë përgjigje shqetësimeve të ndryshme që lidhen me ekstremizmin e dhunshëm. Këto përpjekje do të shërbejnë për veçimin e ekstremizmit të dhunshëm nga çdo grup i caktuar fetar, duke e vënë theksin te trashëgimia e pasur kulturore dhe toleranca fetare e Shqipërisë. Duke e informuar publikun lidhur me përpjekjet e KEDH-së që ndërmerren nga qeveria, ky plan komunikimi do të rritë transparencën, si dhe do të nxitë mbështetjen e besimit e grupeve në rrezik dhe popullsisë, në përgjithësi.

Së dyti, do të hartohen mesazhe dhe do të zhvillohen fushata të konceptuara me kujdes, që i kundërvihen propagandës ekstremiste të dhunshme në internet, duke shfrytëzuar kanale dhe metoda që janë më të prirura për të mbërritur e ndikuar te grupet dhe individët në rrezik.

5. Propozimi i një strategjie krijuese dhe novatore komunikimi, si plotësuese e Strategjisë Kombëtare

Me anë të kësaj mase, qeveria e Shqipërisë do të hartojë një mesazh që synon ta mbajë publikun të informuar për mënyrën se si mund të kontribuojë për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm. Për të pasur një ndikim maksimal, do të ndërmerren veprimet e mëposhtme:



a) Ngritja e një grupi pune për komunikimin, që do të angazhojë aktorë të ndryshëm, si zyrtarë të shtetit, akademikë, medien dhe shoqëritë teknologjike, shoqërinë civile, komunitetet fetare dhe punonjësit e vijës së parë;

b) Nxjerrja e udhëzimeve të komunikimit për partnerët lokalë, që zbatojnë nismat në terren;

c) Rritja e vazhdueshme e ndërgjegjësimit përmes takimeve sistematike në komunitetet e synuara, duke mbledhur bashkëbisedues për të ofruar ide praktike për mënyrën e trajtimit të radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm në nivel lokal.

6. Ndikimi i qëndrimeve dhe sjelljeve kundrejt ekstremizmit të dhunshëm përmes fushatave të përshtatura sipas kontekstit dhe nismave të tjera të komunikimit

Në kuadrin e kësaj fushe kryesore do të identifikohen dhe do të përforcohen strategjitë e teknikat efektive për të luftuar kundër përhapjes së mesazheve e të gjuhës ekstremiste. Më konkretisht, shoqëria civile dhe komunitetet fetare, si dhe media do të mbështeten në hartimin e përcimin e mesazheve të fuqishme dhe historive alternative, që përkrahin tolerancën, paqen, të drejtat e njeriut e vlerat demokratike, përmes veprimeve në vijim:

a) Konceptimit të fushatave të përshtatura në medien sociale, programeve radiofonike e televizive, si dhe llojeve të tjera të nismave që përhapin mesazhe kundër ekstremizmit, të cilat janë në gjendje të depërtojnë tek audiencat e synuara.

**Hartimi i politikave gjithëpërfshirëse afatgjata të KEDH-së**

Qasja mbarëshoqërore e shumë aktorëve dhe e të gjitha institucioneve shtetërore në luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm që është përdorur nga qeveria shqiptare në këtë strategji kërkon përmirësim të vazhdueshëm të politikave dhe masave, që kanë një ndikim domethënës në aftësinë e neutralizimit të mesazheve ekstremiste dhe përpjekjeve të rekrutimit për të depërtuar në komunitetet shqiptare. Sjellja në përputhje me politikat ekzistuese të KEDH-së për rritjen e përpjekjeve parandaluese, së bashku me krijimin e kapaciteteve të duhura të nëpunësve publikë në të gjitha nivelet për të zbatuar këto politika, si dhe mbledhja e të dhënave për politikat përmes hulumtimit, monitorimit dhe vlerësimit kërkojnë një përkushtim afatgjatë. Në dritën e këtyre

konstatimeve, kjo fushë kryesore paraqet masat për përmirësimin e politikëbërjes mbështetur në të dhëna kundër ekstremizmit të dhunshëm në Shqipëri dhe, më gjerë, në rajonin e Ballkanit Perëndimor.

7. Zhvillimi i njohurive dhe ekspertizës për të luftuar kundër ekstremizmit të dhunshëm, përmes hulumtimit dhe rritjes së ndarjes së informacionit

Inteligjenca vepruese, të dhënat, hulumtimet dhe analiza e shkaqeve nxitëse të ekstremizmit të dhunshëm dhe nivelet e qëndresës së komunitetit do të sigurojnë informacion për politikën e KEDH-së në të ardhmen. Shkëmbimi i informacionit do të rritet për të bërë të mundur përmirësimin në njohjen e përgjithshme të procesit të radikalizimit dhe mënyrën për ta luftuar atë. Në mbështetje të kësaj mase, do të ndërmerren veprimet e mëposhtme:

a) Hartimi i protokolleve dhe sistemeve të ndarjes së informacionit për të mbledhur, sistemuar dhe ndarë të dhëna nga një gamë e gjerë burimesh, me qëllim që të mundësohen reagime dhe përpjekje parandaluese efektive dhe në kohë.

b) Mbështetja dhe shfrytëzimi i hulumtimit lokal mbi kushtet, faktorët dhe nxitësit e radikalizimit në dhunë, si dhe nivelet e qëndresës së komunitetit kundrejt ekstremizmit të dhunshëm.

8. Rritja e kapaciteteve të profesionistëve dhe punonjësve të vijës së parë

Aftësia e profesionistëve, që janë në kontakt të drejtpërdrejtë me individët që rrezikohen nga radikalizmi, domethënë, punonjësit e vijës së parë, si mësuesit, punonjësit socialë, oficerët lokalë të policisë dhe institucioneve të riedukimit, për të vlerësuar e mbështetur personat që tërhiqen nga ekstremizmi i dhunshëm, është themelore për zbatimin me sukses të Strategjisë Kombëtare. Për rrjedhojë, do të organizohen kurse formimi dhe do të hartohen materiale e udhëzime lidhur me KEDH-në, që do t'u shpërndahen punonjësve të vijës së parë, përmes veprimeve vijuese:

a) Ofrimit të një trajnimi gjithëpërfshirës për një sërë aktorësh, të cilët merren me luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm, në kuadrin e kësaj strategjie.

b) Hartimit të udhëzimeve për punonjësit e vijës së parë për identifikimin e shenjave të radikalizimit dhe për ndërhyrje në raste individuale.

9. Vlerësimi i politikave të KEDH-së: zbatimi dhe ndarja e mësimave të nxjerrja



Politikat efektive të KEDH-së kërkojnë bashkërendim horizontal e vertikal, si dhe bashkëpunim të integruar, gjithëpërfshirës e afatgjatë në sektorët e sigurisë dhe zhvillimit. Për rrjedhojë, qeveria shqiptare zbaton një qasje tërësore karshi KEDH-së, duke rekomanduar veprimet në vijim:

a) Krijimin e një mekanizmi monitorimi për mbledhjen e të dhënave për raportim e analizë.

b) Vlerësimin e ndikimit të masave individuale të kësaj strategjie dhe përpilimin e mësimëve përkatëse të nxjerra nga ndërhyrjet në komunitetet problematike të synuara.

c) Përshtatje e mëtejshme e politikave të integruara të KEDH-së për rritjen e ndikimit dhe efektivitetit të tyre, mbështetur në gjetjet vlerësuese, në konsultim me komunitetet vendore.

10. Zhvillimi i partneriteteve në nivel rajonal e ndërkombëtar

Me qëllim që të përparohet më tej me kapacitetet dhe ekspertizën e brendshme të KEDH-së, si dhe të përvetësohen mësimet e nxjerra e praktikak më të mira, qeveria e Shqipërisë do të mbështetet në veprimtarinë e platformave, kuadreve dhe organizatave rajonale dhe ndërkombëtare, si Procesi i Bashkëpunimit të Evropës Juglindore dhe Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal, Rrjeti i BE-së për Ndërgjegjësimin ndaj Radikalizimit, Forumi Global kundër Terrorizmit, Hedayah dhe Fondi Global për Angazhimin dhe Qëndresën e Komunitetit.

Përveç kësaj, Qeveria e Shqipërisë do të vihet në krye të një nisme rajonale kushtuar rritjes së kapaciteteve dhe bashkëpunimit kundër ekstremizmit të dhunshëm në Ballkanin Perëndimor, bazuar mbi përvojën, ekspertizën dhe veprimtaritë gjatë zbatimit të kësaj strategjie. Programet dhe aktivitetet që do të zhvillohen në kuadrin e kësaj nisme rajonale do të përfshijnë ndarjen dhe zgjerimin e studimit lokal mbi shkaqet nxitëse të ekstremizmit të dhunshëm dhe masat për t'iu kundërvënë atij; trajnimin e ligjzbatuesve për t'u angazhuar në komunitet e për të identifikuar shenjat e hershme të radikalizimit dhe organizimin e fushatave të bashkërenduara publike në platformat e medias sociale e tradicionale për t'iu kundërvënë

dhe për të ofruar alternativa kundrejt mesazhit të ekstremizmit të dhunshëm. Në mbështetje të kësaj mase do të ndërmerren veprimet e mëposhtme:

a) Luajtja në vazhdimësi e një roli proaktiv, goftë në nivelet rajonale, ashtu edhe në ato ndërkombëtare, për organizimin e evenimenteve tematike dhe pjesëmarrjen në to, si tryeza të rrumbullakëta, konferenca e diskutime për të shfaqur arritjet shqiptare në luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe për të shkëmbyer praktikak më të mira.

b) Dalja me një nismë mbarërajonale për ngritjen e kapaciteteve të KEDH-së në Ballkanin Perëndimor për t'i dhënë shtysë angazhimit të Shqipërisë për krijimin e instrumenteve të përparuara për të luftuar ekstremizmin e dhunshëm e për të kontribuar në përpjekjet kundër ekstremizmit të dhunshëm në një shkallë më të gjerë.

#### **Zbatimi**

Për të zbatuar efektivisht Strategjinë Kombëtare për Luftën kundër Ekstremizmit të Dhunshëm, qeveria e Shqipërisë do të hartojë procedurat dhe rregulloret përkatëse, si dhe do të krijojë struktura ndërinstitucionale. Nisma do të kryesohet nga zyra e Kryeministrit, me kontributet e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Ministrisë së Mbrojtjes. Kjo e fundit do të angazhohet për të luajtur rol lehtësues gjatë gjithë procesit të zbatimit.

Përparësitë, masat dhe veprimet e paraqitura më sipër janë më së shumti ndërsektoriale dhe ndërinstitucionale. Megjithatë, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë do të jetë institucioni udhëheqës, sa i përket shtrirjes dhe angazhimit në komunitet, si dhe për shënjestrimin e grupeve të mënjanuara, në nevojë, të papuna apo të cilave iu duhet dhënë ndihmë sociale.

Ministria e Arsimit dhe Sportit do të drejtojë aktivitetet lidhur me arsimin, në të cilat mësuesit do të kenë rol parësor për zbatimin e objektivave duke shënjestruar studentët, prindërit dhe komunitetet.

Së fundi, Ministria e Punëve të Brendshme do të mbikëqyrë proceset e ndarjes së informacionit.





SHTOJCË  
PLANI I VEPRIMIT  
VËSHTRIM I STRATEGJISË KOMBËTARE  
PËR LUFTËN KUNDËR EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM

Përparësia	Masa	Veprimi i propozuar
Shtrirja dhe angazhimi në komunitet	1. Nxitja e mendimit kritik, pjesëmarrjes civile dhe përhapja e vlerave të tolerancës përmes arsimit	a) Zgjerimi i rrjetit, “Shkolla si qendër komunitar”, për t’u shtrirë në zonat problematike. b) Fuqizimi dhe trajnimi i mësuesve për të shquar e reaguar ndaj shenjave të radikalizimit. c) Rritja e mbështetjes për përpjekjet shkollore e jashtëshkollore në shkollat e vëna në shënjestër për të parandaluar radikalizmin, përfshi edukimin civil e fetar, nismat artistike dhe sportive, klubet e debateve dhe veprimtari të ngjashme që ndërtojnë qëndresën.
	2. Trajtimi i nxitësve social-ekonomikë të radikalizimit përmes arsimit dhe formimit profesional (AFP) dhe shërbimeve të punësimit	a) Zgjerimi i shërbimeve kombëtare të punësimit dhe mbështetjes së tregut aktiv të punës për t’u shtrirë te grupet dhe individët më në rrezik. b) Ofrimi i formimit profesional në zonat problematike të synuara (përfshirë njësitë e lëvizshme ose satelite), përshtatur me nevojat e popullsisë lokale. c) Krijimi i nismave të formimit profesional dhe ndihmës për punësim në institucionet riedukuese, për të lehtësuar rehabilitimin dhe riintegrimin e autorëve të veprës së ekstremizmit të dhunshëm. d) Mbështetja e nismave publike dhe private që krijojnë mundësi punësimi, sipërmarrjes sociale dhe fuqizimit ekonomik të grave në zonat problematike të synuara.
	3. Ndërtimi i besimit dhe besueshmërisë dhe rritja e sigurisë së komunitetit përmes policimit në komunitet	a) Rritja e kapaciteteve të policimit në komunitet në zonat problematike të synuara.
	4. Fuqizimi i shoqërisë civile për të ndërtuar qëndresën e komunitetit	a) Shpallja e thirrjeve për propozime për projekte që synojnë parandalimin e radikalizmit dhe rritjen e qëndresës së komunitetit kundrejt ekstremizmit të dhunshëm.
Lufta kundër propagandës së ekstremizmit të dhunshëm, së bashku me përhapjen e vlerave demokratike	5. Propozimi i një strategjie komunikimi krijuese dhe novatore, si plotësuese e Strategjisë Kombëtare	a) Ngritja e një grupi pune për komunikimin, ku marrin pjesë aktorë të ndryshëm, si: zyrtarë të shtetit, akademikë, media dhe kompani teknologjike, shoqëria civile, komunitetet fetare dhe punonjësit e vijës së parë. b) Nxjerrja e udhëzimeve të komunikimit për partnerët lokalë, që do të zbatojnë nismat në terren. c) Ndërgjegjësim i vazhdueshëm përmes takimeve sistematike në komunitetet e synuara, duke mbledhur bashkëbiseduesit lokalë për të ofruar ide praktike për mënyrën e përbaljes me radikalizmin dhe ekstremizmin e dhunshëm në nivel lokal.
	6. Ndikimi i qëndrimeve dhe sjelljeve karshi ekstremizmit të dhunshëm, me anë të fushatave të përshtatura në kontekst dhe nismave të tjera komunikuese	a) Zhvillimi i fushatave të përshtatura në medien sociale, programe televizive dhe radiofonike dhe lloje të ndryshme nismash që përhapin mesazhe kundër terrorizmit që janë në gjendje të mbërrijnë tek audiencat e synuara.



<b>Hartimi i politikave gjithëpërfshirëse afatgjata të KEDH-së</b>	7. Zhvillimi i njohurive dhe ekspertizës kundër ekstremizmit të dhunshëm përmes rritjes së ndarjes së informacionit	a) Krijimi i protokolleve dhe sistemeve të ndarjes së informacionit, për të mbledhur, sistemuar dhe ndarë të dhënat nga një gamë e gjerë burimesh, për të siguruar kundërpërgjigje dhe përpjekje parandaluese efektive dhe në kohë.
		b) Mbështetje dhe shfrytëzim i hulumtimit lokal të kushteve, faktorëve dhe nxitësve të radikalizmit në dhunë, si dhe nivelet ekzistuese të qëndresës së komunitetit kundrejt ekstremizmit të dhunshëm.
	8. Rritja e kapaciteteve të profesionistëve dhe punonjësve të vijës së parë	a) Ofrimi i një trajnimi gjithëpërfshirës për një sërë aktorësh të ndryshëm, të cilët do të merren me ekstremizmin e dhunshëm, në kuadrin e kësaj Strategjie.
		b) Hartimi i udhëzimeve për punonjësit e vijës së parë për identifikimin e shenjave të radikalizmit e ndërhyrjen në raste individuale.
	9. Vlerësimi i politikave të KEDH-së: zbatimi dhe ndarja e mësimave të nxjerra	a) Krijimi i një mekanizmi monitorues për mbledhjen e të dhënave për raportim e analizë.
		b) Vlerësimi i ndikimit të masave individuale të kësaj Strategjie dhe përpilimi i mësimave përkatëse të nxjerra nga ndërhyrjet në komunitetet problematike të synuara.
		c) Përshtatje e mëtejshme e politikave të integruara të KEDH-së për të rritur ndikimin dhe efektivitetin e tyre, bazuar mbi gjetjet vlerësuese, në konsultim me komunitetet.
	10. Zhvillimi i partneriteteve në nivelet rajonale dhe ndërkombëtare	a) Luajtja në vazhdimësi e një roli proaktiv, në nivel rajonal e ndërkombëtar, për organizimin dhe pjesëmarrjen në evenimente tematike, si tryeza të rumbullakëta, konferenca dhe diskutime për të ekspozuar arritjet e Shqipërisë në luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe për të ndarë praktikrat më të mira.
		b) Fillimi i një nisme mbarërajonale për ngritjen e kapaciteteve të KEDH-së, për të rritur angazhimin e Shqipërisë në zhvillimin e instrumenteve të përparuara për të luftuar kundër ekstremizmit të dhunshëm në një shkallë më të gjerë.

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2015

Adresa  
Bulevardi “Gjergj Fishta”,  
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”,  
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 84 lekë